





# RAPORTI VJETOR 2025



[www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)

Prishtinë, Mars 2026

# RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2025



## VENDIM

Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës miratoi Raportin Vjetor të TK Sh.A. për vitin 2025 në mbledhjen me nr. 22 të mbajtur me datë: 16.03.2026



Delegoi

**Burbuqe Hana**

Kryeshefe Ekzekutive – Telekomit të Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

16.03.2026



Aprovoi

**Sajmie Thaçi**

U.D. Kryesuese e Bordit të Drejtorëve - Telekomit të Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

16.03.2026



I.	Lista e Tabelave.....	1
II.	Lista e Grafikëve /Figurave.....	1
III.	PROFILI I SHKURTËR I KOMPANISË.....	3
IV.	RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE.....	4
A.	TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIVË .....	5
V.	FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS.....	6
VI.	RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE.....	7
A.	NGJARJET KRYESORE TË VITIT .....	7
B.	PASQYRAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKIMEVE NË KOSOVË.....	8
C.	PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCËS .....	9
D.	PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET 2025 .....	11
E.	PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT.....	11
F.	SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET .....	13
G.	PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN.....	14
H.	RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATËS.....	14
I.	KALENDARI FINANCIAR .....	15
VII.	Shtojca.....	15
A.	RAPORTIMET SIPAS LIGJIT MBI NËRDMARRJET PUBLIKE .....	15
i.	Pasqyrat e strukturës organizative .....	16
ii.	Përmbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë korporatën.....	17

## I. Lista e Tabelave

Tabela 1.	Numri i takimeve të Bordit.....	5
Tabela 2.	Komitetet e Bordit .....	5
Tabela 3.	Analiza e të Hyrave: Krahasimi 2025 vs 2024 .....	8
Tabela 4.	Mbulueshmëria me shërbime mobile.....	9
Tabela 5.	Numrat aktiv të Vala .....	9
Tabela 6.	Kontributi i njësisve operative në të hyra totale.....	11
Tabela 7.	Rezultatet e performancës financiare - krahasimi me vitet paraqake.....	11
Tabela 8.	Bilanci i gjendjes.....	12
Tabela 9.	Pasqyra e të ardhurave .....	12
Tabela 10.	Procedurat gjyqësore.....	17

## II. Lista e Grafikëve /Figurave

Figura 1	Struktura e re organizative .....	16
----------	-----------------------------------	----

## Shkurtesat

TK	Telekomi i Kosovës
AB	Auditori i Brendshëm
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
QoS	Kualiteti i Shërbimeve (Quality of Service)
BTS	Base Transceiver Station – Stacion Bazë
NGN	Next Generation Network – Rrjet i Gjeneratës së Re
EWSD	Electronic Worldwide Switch Digital
ITU	International Telecommunication Union – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
ETS	Emergency Telecommunications Service – Shërbimi Emergjent i Telekomunikacionit
IPTV	Internet Protocol Television – Televizion përmes Protokollit të Internetit
POSTPAID	Konsumatorë me faturë mujore
PREPAID	Konsumatorë me parapagim
SMS	Short Message Service – Shërbimi i mesazheve me tekst
ARPU	Average Revenue Per User – Të ardhurat mesatare për konsumator
OTT	Over-The-Top – Shërbime dhe aplikacione online për komunikim dhe media
LTE	Long Term Evolution – Standard i evolucionit afatgjatë për rrjetet mobile
IP	Internet Protocol – Protokollit i Internetit
2G	Gjenerata e dytë e komunikimeve mobile
3G	Gjenerata e tretë e komunikimeve mobile
4G	Gjenerata e katërt e komunikimeve mobile
5G	Gjenerata e pestë e komunikimeve mobile
GSM	Global System for Mobile Communications
GPRS	General Packet Radio Service – Platformë për shërbimin e internetit
EBITDA	Earnings Before Interest, Taxes, Depreciation and Amortization – Fitimi para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit
CAPEX	Capital Expenditures – Investimet kapitale
ISP	Internet Service Provider – Ofrues i shërbimit të internetit
FTTH	Fiber to the Home – Fibër optike deri te konsumatori
VoLTE	Voice over LTE – Thirrje me zë përmes rrjetit LTE
OLT	Optical Line Terminal
ONT	Optical Network Terminal
eSIM	Embedded SIM – Kartë SIM e integruar digjitale
RAN	Radio Access Network – Rrjeti i qasjes radio

### III. PROFILI I SHKURTËR I KOMPANISË

Telekomi i Kosovës (TK) është një kompani publike që operon në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Si një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve dhe produkteve të komunikimeve elektronike në vend, Telekomi i Kosovës Sh.A synon të udhëheqë zhvillimin e këtij sektori duke ofruar një portofol të gjerë shërbimesh në telefoninë mobile, atë fikse dhe përmbajtje televizive, me fokus në përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive të konsumatorëve.

Për periudhën 2025–2027 prioritet mbetet forcimi i stabilitetit financiar dhe zhvillimi i qëndrueshëm i kompanisë, përmes realizimit të objektivave strategjike dhe përshtatjes së vazhdueshme me kërkesat e tregut për produkte dhe shërbime telekomunikuese cilësore.

Si një shtyllë e rëndësishme në industrinë e komunikimeve elektronike në Kosovë, Telekomi i Kosovës është i përkushtuar të transformohet nga një kompani e fokusuar kryesisht në shërbimet tradicionale të zërit, në një ofrues të avancuar të shërbimeve të të dhënave dhe internetit me shpejtësi të lartë, duke mundësuar qasje në teknologjitë më të reja për të gjithë konsumatorët.

Në këtë drejtim, kompania vazhdon të investojë në modernizimin e rrjeteve telekomunikuese, zgjerimin e infrastrukturës optike, sigurinë e rrjetit si dhe zhvillimin e shërbimeve të reja digjitale, duke krijuar bazën për rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Në një kohë të globalizimit dhe zhvillimeve të shpejta teknologjike, Telekomi i Kosovës mbetet i fokusuar në inovacion, efikasitet operacional dhe përmirësimin e përvojës së klientëve, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të ofruar produkte dhe shërbime moderne të përshtatura me kërkesat e tregut.

#### IV. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

I nderuari Aksionar,

Ju drejtohem në cilësinë e Ushtrueses së Detyrës (UD) së Kryesueses së Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës për të prezantuar Raportin Vjetor të Telekomit të Kosovës Sh.A për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Bordi i Drejtorëve ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse të këtij ligji.

Viti 2025 ka qenë një vit i rëndësishëm për Telekomin e Kosovës, duke shënuar progres të dukshëm si në aspektin financiar ashtu edhe në zhvillimin e projekteve strategjike të infrastrukturës telekomunikuese.

Sa i përket performancës financiare për vitin 2025, Telekomit i Kosovës ka vazhduar trendin e përmirësimit të rezultateve financiare. Krahasuar me vitin 2024, të hyrat e Telekomit të Kosovës në vitin 2025 janë më të larta për rreth 14.38%, bazuar në pasqyrat financiare të paaudituar. Gjatë vitit 2025, Telekomit i Kosovës ka realizuar EBITDA pozitive në vlerë prej 19.5 milionë euro — rezultat më i favorshëm për rreth 5.6 milionë euro krahasuar me EBITDA-n e vitit 2024 (13.9 milionë euro).

Fitimi para tatimit për vitin 2025 arrin vlerën prej 9.7 milionë euro, që është për 3.2 milionë euro më i lartë krahasuar me vitin 2024, kur fitimi ishte 6.5 milionë euro. Krahasuar me buxhetin, rezultati i arritur është më i favorshëm për 8.0 milionë euro, duke qenë se fitimi i planifikuar kishte qenë 1.7 milionë euro.

Gjatë këtij viti, Telekomit i Kosovës ka vazhduar implementimin e projekteve të rëndësishme për modernizimin dhe zgjerimin e rrjeteve telekomunikuese. Përfundimi i fazave kryesore të modernizimit të rrjetit mobil — përfshirë jetësimin e MCC 221 (kodit shtetëror të RKS-së) në nëntor 2025 — si dhe implementimi i LTE në brezin 2100 MHz, përbëjnë hapa kyç drejt ofrimit të shërbimeve cilësore.

Procesi i ristrukturimit dhe përmirësimit të organizimit të brendshëm ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional. Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me klientët mbetet një nga prioritetet kryesore.

Telekomit i Kosovës mbetet i përkushtuar ndaj përgjegjësisë sociale dhe kontributit në zhvillimin e komunitetit.


Në emër të Bordit të Drejtorëve, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për Menaxhmentin Ekzekutiv dhe për të gjithë punonjësit e Telekomit të Kosovës për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë këtij viti, si dhe për klientët tanë për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme.

Sinqerisht,

UD Kryesuese e Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A.

a. Të dhënat për drejtorët joekzekutivë

Struktura paraqet emrat e drejtorëve joekzekutivë, kryeshefes ekzekutive dhe sekretarit të korporatës.



Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A, i emëruar me Vendimin e Qeverisë nr. 04/214, më datë 24.07.2024

Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore (në këtë rast, Telekom Kosovës Sh.A.) bëhet sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.07/81, datë: 23.03.2016.

Numri i takimeve të bordit gjatë vitit dhe numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e BtD

Takimet e bordit	Numri i takimeve	Numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takime të bordit
Takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve	12	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryesuesi<sup>1</sup></li> <li>• 3 Drejtorët e Bordit</li> <li>• Kryeshefja Ekzekutive dhe</li> <li>• Këshilltari i Përgjithshëm/ Sekretari i Korporatës</li> </ul>

Tabela 1. Numri i takimeve të Bordit

Komitetet e bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Komiteti i Auditimit <sup>2</sup>	10	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sajmie Thaçi, Kryesuese</li> <li>• Rrezarta Pllana, Anëtare</li> <li>• Lindita Toçi, Anëtare</li> <li>• Kujtim Saraçi, Zyrtar i Auditimit të Brendshëm</li> <li>• Selvete Xhigoli, UD Zyrtare e Auditimit të Brendshëm</li> <li>• Shekip Fazliu, Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretar i Korporatës</li> </ul>
-----------------------------------	----	---

Tabela 2. Komitetet e Bordit

Sinqerisht,

znj. Sajmie Thaçi – UD Kryesuese e Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A

<sup>1</sup> Me dorëheqjen e ofruar me shkrim nga z. Petrit Nahi më 07.10.2025, në pozitën e Ushtrueses së Detyrës së Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve është emëruar znj. **Sajmie Thaçi**, me Vendim të Ministrisë së Ekonomisë/Qeveria e RKS nr.01-4315 dt.07.11.2025.

<sup>2</sup> Me pranimin e dorëheqjes me shkrim të z. Kujtim Saraçi nga pozita e ZAB më 14.04.2025, në pozitën e Ushtrueses së Detyrës së Zyrtarit të Auditorit të Brendshëm është emëruar znj. Selvete Xhigoli, me Vendim të Komisionit të Auditimit nr.01-2099/25 dt.14.04.2025.

## V. FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS

### VITI I KONSOLIDIMIT DHE ZHVILLIMIT TË MËTEJSHËM TË INFRASTRUKTURËS TELEKOMUNIKUESE

Nëse vitet e fundit kanë shënuar fillimin e procesit të rimëkëmbjes dhe modernizimit të Telekomit të Kosovës, viti 2025 mund të konsiderohet si një vit i konsolidimit të këtij progresi dhe i zhvillimit të mëtejshëm të projekteve strategjike të kompanisë.

Gjatë këtij viti, Telekomit i Kosovës ka vazhduar investimet në modernizimin e rrjetit mobil dhe zgjerimin e rrjetit optik fiks, duke krijuar bazën për ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe për zhvillimin e shërbimeve të avancuara digjitale për konsumatorët.

Modernizimi i rrjetit mobil dhe investimet në teknologjitë më të avancuara kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të zërit dhe internetit mobil, duke rritur kapacitetet teknike të rrjetit dhe përvojën e përdoruesve. Në këtë segment, Telekomit tani ofron shërbime të sigurta dhe më kualitative në treg, të mbështetura në rrjetin e modernizuar dhe në standardet më të larta të teknologjisë.

Paralelisht me këto investime, gjatë vitit 2025 ka vazhduar implementimi i projektit të zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit optik në të gjithë territorin e Kosovës. Ky projekt strategjik do të mundësojë zhvillimin e shërbimeve të internetit me shpejtësi shumë të lartë dhe do të krijojë mundësi të reja për zhvillimin e shërbimeve konvergjente mobile dhe fikse.

Në aspektin financiar, Telekomit i Kosovës ka vazhduar të operojë me rezultate pozitive. Viti 2025 u mbyll me një fitim neto prej rreth 9.7 milionë euro, edhe përkundër faktit se edhe në pesë muajt e parë të vitit 2025 ndërmarra është përballur me xhirrollogari të bllokuara nga rasti i kontratës me Z-Mobile (Dardafon) të denoncuar si korruptive, prej të cilave Telekomit i janë tërhequr rreth 16 milionë euro.

Ky fitim është arritur falë menaxhimit permanent të kujdesshëm të shpenzimeve në njërin anë dhe punës serioze të vazhdueshme të punonjësve profesionistë të ndërmarrjes në anën tjetër.

Edhe gjatë këtij viti, kompania është përballur me sfidat që rrjedhin nga kontratat dhe obligimet e trashëguara nga e kaluara. Megjithatë, përmes punës së koordinuar të ekipeve menaxheriale dhe ligjore, Telekomit i Kosovës ka arritur të menaxhojë këto sfida dhe të ruajë stabilitetin financiar të kompanisë, duke bërë kështu të qartë se reformat dhe menaxhimi i përgjegjshëm po japin rezultat.

Zhvillimi, ligjshmëria dhe transparencja mbeten parimet udhëheqëse të veprimtarisë së Telekomit të Kosovës. Raportimi i saktë dhe transparent ndaj Bordit të Drejtorëve, aksionarit, institucioneve shtetërore dhe publikut mbetet pjesë thelbësore e qeverisjes së korporatës.

Sinqerisht,

Burbuqe Hana - Kryeshefe Ekzekutive e TK Sh.A

## VI. RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE

Përkundër sfidave operative dhe teknike, Telekom i Kosovës gjatë vitit 2025 ka arritur të realizojë objektivat kryesore të Planit të Biznesit dhe të vazhdojë implementimin e projekteve strategjike për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës telekomunikuese.

Viti 2025 është karakterizuar nga progresi i rëndësishëm në realizimin e projekteve kapitale, veçanërisht në modernizimin e rrjetit mobil dhe migrimin në kodin shtetëror MCC 221, si dhe fillimin e implementimit të zgjerimit të rrjetit optik fiks në të gjithë territorin e Kosovës.

Të hyrat totale për vitin 2025 arritën në rreth 67.8 milionë euro, ndërsa kompania realizoi EBITDA pozitive prej 19.5 milionë euro dhe fitim neto rreth 9.7 milionë euro.

Në vijim të këtij raporti, janë ofruar informata për:

- a) ngjarjet kryesore të vitit,
- b) pasqyrën e tregut të telekomunikimeve në Kosovë,
- c) pasqyrën e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës,
- d) performancën financiare,
- e) progresin në planin e biznesit,
- f) shpenzimet kapitale dhe projektet,
- g) perspektivën për të ardhmen,
- h) rreziqet e të ardhmes.
- i) kalendarin financiar.

### a. Ngjarjet kryesore të vitit

Viti 2025 karakterizohet si një periudhë me dinamikë të lartë transformimi për Telekomin e Kosovës, me arritje të rëndësishme në modernizimin e rrjetit, hulumtimin e tregut, kampanjat promovionale, lansimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, si dhe aktivitetet e përgjegjësive sociale.

#### Të arriturat kryesore dhe zhvillimet e vitit:

- Modernizimi i rrjetit optik dhe zgjerimi i shërbimeve 4G+/5G me ndikim të drejtpërdrejtë në kënaqshmërinë e klientëve.
- Jetësimi i MCC 221 (kodi shtetëror i RKS-së) - u përmbyll me sukses në nëntor 2025.
- Pranimi zyrtar i sistemit për Bartshmërinë e Numrave (NPC) - sistemi u pranua më 12.11.2025; lansimi komercial është i planifikuar për 31 mars 2026.
- Marrëveshja e re me Dividend për blerjen e të drejtave ekskluzive të transmetimit të Kampionatit Botëror të Futbollit 2026.
- Lansimi i pakove dhe shërbimeve të reja - FWA, DDoS, OTT, Data Home, Payphone dhe pakot promovionale Prepaid.
- Rritja e ARPU për segmentin Prepaid me 17% dhe rritja e të hyrave nga pikat e shitjes me 25.91%.
- Rritja e të hyrave nga aplikacioni 'Vala Jonë' me 99.80%.
- Kampanja 'Diaspora Jonë' me rritje të shitjeve prej 56.64%.
- Brendimi i 10 pikave të shitjes; hapja e 3 pikave të reja në Ferizaj, Pejë dhe Gjakovë.
- Rritja e ARPU për Internet (+3%) dhe IPTV kombinim (+3%).
- Aktivitetet sociale në mbështetje të komuniteteve vulnerabël (gratë, fëmijët, të moshuarit, pacientët).
- 5,563 orë trajnimi të realizuara për 1,319 pjesëmarrës në pesë module, duke mbuluar të gjitha regjionet.

## b. Pasqyrat e Tregut të Telekomunikimeve në Kosovë

Tregu i telekomunikimeve në Kosovë ka treguar qëndrueshmëri të lartë gjatë vitit 2025. Të hyrat totale të sektorit arritën në rreth 189.5 milionë euro, rritje prej 8.8% krahasuar me 174 milionë euro të vitit 2024.

<i>Periudha</i>	<i>Të Hyrat 2024 (milionë €)</i>	<i>Të Hyrat 2025 (milionë €)</i>	<i>Trendi</i>
<i>TM1</i>	41.2	45.1	+9.4%
<i>TM2</i>	43.5	47.2	+8.5%
<i>TM3</i>	44.8	49.3	+10.0%
<i>TM4</i>	44.6	47.9	+7.4%
<i>TOTAL</i>	174.1	189.5	+8.8%

Tabela 3. Analiza e të Hyrave: Krahasimi 2025 vs 2024

Tregu i telefonisë mobile vazhdon të dominojë me rreth 71% të të hyrave totale (~126 milionë euro). Numri i përdoruesve në TM4-2025 arriti në 1,977,416, rritje prej 2.14% krahasuar me TM4-2024. Indikatorin ARPU tregoi rritje të konsiderueshme: nga rreth 5.50 € në TM4-2024, në rreth 6.90 € në TM4-2025 (+25.45%) çka reflekton rritjen e konsumit të shërbimeve të të dhënave mobile dhe migrimin drejt paketave me vlerë më të lartë.

Tregu i telefonisë mobile, nga këndvështrimi i numrit të përdoruesve, ndahet gati në mënyrë të barabartë (rreth 50%-50%). Kurse, sa i përket pjesëmarrjes në treg sipas të hyrave mobile, Vala mban 44.2%.

Tregu i internetit fiks ka 393,776 linja aktive (TM4-2025), me të hyra prej 12.5 milionë euro në tremujor. Telekomuni i Kosovës mban 5.6% të linjave, por gjeneron 10.6% të të hyrave, duke reflektuar efikasitetin të lartë të të hyrave.

### c. Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

#### i. Shërbimet mobile

Infrastruktura e Telekomit të Kosovës lidhur me shërbimet mobile ofron mbulueshmëri: 2G në bazë të popullsisë në nivel vendi prej rreth 99.8%, ndërsa mbulueshmëri të territorit prej 98.5%; 4G/4G+ në 98.5% të popullsisë dhe 94.5% të territorit; dhe, në 5G mbulueshmëri të 72% të popullsisë dhe 45% të territorit (tabela më poshtë). Kapacitetet teknike të instaluar për konsumatorët prepaid dhe postpaid janë 1.5 milionë. Infrastruktura teknologjike është GSM/GPRS/EDGE, 4G/4G+ dhe 5G.

Mbulueshmëria	2G	4G/4G+	5G
Popullsia	99.80%	98.50%	72.00%
Territori	98.50%	94.50%	45.00%

Tabela 4. Mbulueshmëria me shërbime mobile

Rrjeti radio operon tërësisht me pajisjet e Ericsson NT, me 551 Stacione Bazë (SB) aktive.

Numri i konsumatorëve aktiv në fund të TM4-2025 ishte 903,538.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vetëm numrat aktiv të Vala:

	Në databazën e konsumatorëve (UDM)		prepaid dhe postpaid aktiv	
	2024	2025	2024	2025
2G	921,134	1,088,240	154,155	554,731
4G	689,945	788,846	554,733	623,678
5G	57,545	210,812	20,885	182,805

Tabela 5. Numrat aktiv të Vala

Rritja e konsumatorëve aktiv 5G dhe 4G në gjysmën e dytë të vitit 2025 reflekton implementimin e plotë të projektit të modernizimit dhe jetësimit të MCC 221.

Të hyrat nga roaming në vitin 2025 janë për 21.30% më të larta se viti i kaluar dhe për 12.84% më të larta se plani. Trafiku i të dhënave në roaming është rritur me 47%.

#### ii. Shërbimet fikse

Infrastruktura fikse e TK-së mbështetet në mbi 1,000 km rrjet optik (FTTH dhe FTTN), 150 pika prezence fikse me 350 nyje qasjeje, 416 pika WiFi dhe 2 sisteme komutimi EWSD PSTN me 30 pika qasje RDLU.

Numri i konsumatorëve fiks aktiv (faturë jo-zero) në fund të TM4-2025: 39,560.

### Performanca e Produkteve dhe Shërbimeve

#### Performanca sipas Segmenteve (ARPU dhe Produktet)

Gjatë vitit 2025, Kompania ndërmori iniciativë të synuara për përmirësimin e ofertave ekzistuese dhe lansimin e pakove të reja të shërbimeve. Këto veprime kontribuan në rritjen e vlerës për konsumatorët, duke u reflektuar në rritjen e të Ardhurave Mesatare për Përdorues (ARPU), zgjerimin e bazës së konsumatorëve dhe rritjen e të hyrave në segmentet kryesore.

Segmenti Prepaid shënoi rritje të konsiderueshme, si rezultat i përmirësimit të strukturës së produkteve dhe rritjes së angazhimit të konsumatorëve. Shërbimet fikse, përfshirë Internetin dhe paketat e kombinuara me IPTV, gjithashtu shënuan rritje të qëndrueshme, duke reflektuar kërkesën në rritje për shërbime të integruara.

### **Performanca e Shitjeve**

Gjatë vitit 2025, Kompania ka shënuar rritje të qëndrueshme në shitje dhe të hyra, e nxitur nga optimizimi i ofertave dhe rritja e kërkesës për shërbime të integruara.

Produktet e kombinuara "Fol dhe Internet" vazhduan të jenë kontribuuesi kryesor në të hyrat, duke reflektuar orientimin e konsumatorëve drejt pakove të integruara. Gjithashtu, është vërejtur rritje e konsiderueshme në aktivizimet e reja dhe në shërbimet me vlerë të shtuar.

### **Kanalet e Shitjes dhe Kujdesi për Klientë**

Gjatë vitit raportues, Telekomit ka vazhduar zhvillimin dhe optimizimin e rrjetit të pikave shitëse dhe shërbimeve ndaj klientëve, përmes:

- zgjerimit të pranisë fizike në treg
- përmirësimit të lokacioneve ekzistuese
- ribrendimit dhe modernizimit të pikave kyçe

Në të njëjtën kohë, është rritur fokusi në digjitalizim, duke përfshirë përdorimin e faturimit elektronik dhe kanaleve online për shërbim ndaj klientëve.

### **Segmenti Postpaid dhe Bizneset**

Gjatë vitit 2025, Telekomit ka ndërmarrë hapa për optimizimin e bazës së klientëve Postpaid dhe përmirësimin e efikasitetit operativ. Paralelisht, është shënuar rritje në segmentin e bizneseve të vogla dhe të mesme, si në shërbimet mobile ashtu edhe fikse.

### **Kanale Digjitale dhe Fushata Tregtare**

Kanalet e shitjes kanë shënuar rritje të ndjeshme, veçanërisht:

- pikat fizike të shitjes
- aplikacionet digjitale dhe kanalet online

Rritja e përdorimit të kanaleve digjitale reflekton ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve drejt shërbimeve më të shpejta dhe më të qasshme.

Fushatat sezonale, përfshirë ofertat për diasporën, kanë kontribuar në rritjen e shitjeve dhe aktivizimeve të reja, si dhe në promovimin e produkteve inovative si eSIM.

### **Shërbimi ndaj Klientëve**

Gjatë vitit 2025, Kompania ka përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e shërbimit ndaj klientëve, duke arritur:

- ulje të numrit të ankesave
- rritje të shkallës së zgjidhjes në kontaktin e parë (FCR)
- përmirësim të kohës së përgjigjes

#### d. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2025

Falë ndërmarrjes së masave për rritjen e të hyrave, investimeve në teknologji, modifikimit të pakove dhe reduktimit të shpenzimeve, edhe në vitin 2025 ka vazhduar trendi pozitiv i forcimit të stabilitetit financiar.

Gjatë pesë muajve të parë të vitit 2025, llogaritë bankare të kompanisë mbetën të bllokuara (që nga tetori 2024), për shkak të borxheve nga kontestet gjyqësore (rreth 16 milionë euro). Pavarësisht kësaj situate, kompania arriti të vazhdojë operimin dhe të përmbushë detyrimet kryesore financiare.

#### Të hyrat totale

Në vitin 2025 janë realizuar të hyra totale në vlerë prej 67,819k Euro — për 8.77% më të larta se plani i buxhetit 2025 (62,351k Euro) dhe për 14.38% më të larta se në vitin 2024 (59,295k Euro).

Proporcioni i të hyrave nga shërbimeve mobile ndaj atyre fikse: rreth 88% me 12%, në favor të të hyrave mobile.

Kontributi i njësive operative në të hyra totale								
'000	Aktual 2025	Plani për vitin 2025	Ndryshimi në %	Ndryshimi në vl. absol.	Aktual 2025	Aktuali 2024	Ndryshimi në %	Ndryshimi në vl. absol.
Të hyrat totale	67,819	62,351	8.77%	5,469	67,819	59,295	14.38%	8,524
Shërbimet mobile	59,363	54,735	8.45%	4,628	59,363	51,506	15.25%	7,857
Shërbimet fikse	8,089	7,261	11.4%	828	8,089	7,469	8.30%	620
Donacionet nga Qeveria	368	355	3.7%	13	368	321	14.74%	47

Tabela 6. Kontributi i njësive operative në të hyra totale

Të hyrat e realizuara nga shërbimet e telefonisë mobile gjatë vitit 2025 janë 59,363k Euro (+8.45% mbi plan; +15.25% mbi 2024). Të hyrat e realizuara nga shërbimet e telefonisë fikse janë 8,089k Euro (+11.40% mbi plan; +8.30% mbi 2024).

#### e. Progresi me Planin e Biznesit

Krahasuar me buxhetin e vitit 2025, kompania tejkaloi planifikimin e të hyrave duke realizuar 108.77% të planit (67,819k Euro nga 62,351k Euro të planifikuara). Krahasuar me vitin 2024, të hyrat janë realizuar 114.38% ose janë 14.38% më të larta.

Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në masën 95.83% të planit (58,118k Euro nga 60,645k Euro), ndërsa janë 10.57% më të larta se ato të vitit 2024 (52,561k Euro).

Sipas planit të biznesit 2025, ishte parashikuar fitim prej 1,705k Euro, por falë rritjes së të hyrave dhe uljes së shpenzimeve, kompania mbylli vitin me fitim prej 9,702k Euro — tejkalim i planit me 7,996k Euro.

Tregues	Plan 2025	Arritur 2025	Arritur 2024
Të hyrat totale	62,351k €	67,819k €	59,295k €
EBITDA	12,056k €	19,489k €	13,935k €
Fitimi pas tatimit	1,705k €	9,702k €	6,487k €

Tabela 7. Rezultatet e performancës financiare - krahasimi me vitet paraprake

Në tabelat në vijim janë të prezantuara pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave  
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025 në Telekomin e Kosovës

Përshkrimi	31.12.2025 (€000)	31.12.2024 (€000) (i rideklaruar)
Asetet jo-qarkulluese	53,846	59,236
Asetet qarkulluese	18,128	20,949
<b>Gjithsej Asetet</b>	<b>71,974</b>	<b>80,185</b>
Ekuiteti	-493	- 10,003
Detyrimet jo-qarkulluese	45,189	42,095
Detyrimet qarkulluese	27,278	48,093
<b>Gjithsej Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	<b>71,974</b>	<b>80,185</b>

Tabela 8. Bilanci i gjendjes

Pasqyra e të Ardhurave të Telekomit të Kosovës për vitin 2025

Përshkrimi	2025 (€000)	2024 (€000) (i rideklaruar)
Të hyrat totale	67,819	59,295
Kosto e shitjes (KMSH)	-14,113	-13,585
<b>Fitimi bruto</b>	<b>53,706</b>	<b>45,710</b>
Shpenzime operative	-30,780	-27,786
<b>EBITDA</b>	<b>19,489</b>	<b>13,935</b>
Amortizimi	-13,225	-11,189
<b>EBIT (Fitimi para tatimit)</b>	<b>9,702</b>	<b>6,735</b>
Shpenzime financiare	—	—
Tatimi në fitim	—	-248
<b>Fitimi neto (pas tatimit)</b>	<b>9,702</b>	<b>6,487</b>

Tabela 9. Pasqyra e të ardhurave

#### Shënim mbi ri-deklarimin e pasqyrave financiare 2024:

Gjatë vitit 2025, Menaxhmenti prezantoi para Bordit dhe Sindikatës strategjinë për pagesën e detyrimeve nga Marrëveshja Kolektive e vitit 2019 (shujtë, pagë jubilarë, pagë e përvojës). Janë nënshkruar marrëveshje me 1,378 punëtorë, me vlerë totale 5,099,088.95 € për 24 muaj. Pagesa ka filluar nga gushti 2025. Pasqyrat financiare të vitit 2024 janë ri-deklaruar në përputhje me standardet e kontabilitetit.

#### **f. Shpenzimet kapitale dhe projektet**

Viti 2025 ka shënuar progres të konsiderueshëm në të gjitha projektet kryesore kapitale. Me Planin e Biznesit 2025, janë aprovuar investime kapitale gjithsej prej 29,956k Euro (mobile 16,060k €, fikse 13,294k €, shërbime mbështetëse 602k €).

Gjatë vitit 2025, janë realizuar pagesa CAPEX gjithsej prej 6,168k Euro (mobile 4,370k €, fikse 1,797k €). Janë nënshkruar kontrata me vlerë 8,977k Euro.

Gjatë vitit 2025, Kompania ka fokusuar investimet kapitale në modernizimin e infrastrukturës, zgjerimin e rrjetit dhe krijimin e bazës për zhvillime të mëtejshme teknologjike. Këto investime janë orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së kapaciteteve të rrjetit në të gjithë territorin e Kosovës.

#### **Projektet kryesore përfshijnë:**

##### **Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe modernizimi i rrjetit mobil**

Gjatë vitit 2025 është përmbyllur me sukses migrimi në kodin telefonik të Republikës së Kosovës (MCC 221), duke përfshirë përditësimin masiv të kartave SIM. Paralelisht, është avancuar modernizimi i rrjetit mobil përmes zgjerimit të kapaciteteve LTE dhe janë ndërmarrë hapa drejt implementimit të teknologjisë VoLTE, i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2026.

##### **Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit në nivel vendi**

Kompania ka vazhduar investimet në zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit telekomunikues në të gjithë vendin përmes projekteve shumëvjeçare infrastrukturore, duke rritur mbulueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve.

##### **Zhvillimi i rrjetit optik (FTTH)**

Janë realizuar investime në pajisje dhe teknologji të avancuara për zhvillimin e rrjetit optik, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve me kapacitet të lartë dhe cilësi të përmirësuar për konsumatorët, si dhe duke krijuar bazë afatgjatë për zëvendësimin e infrastrukturës ekzistuese.

##### **Projekti i Ekonomisë Digjitale për Kosovën (KODE)**

Projekti është përmbyllur me sukses gjatë vitit 2025, duke kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës digjitale. Kompania ka përfituar mbështetje financiare për realizimin e këtij projekti, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

##### **Bartshmëria e numrave (Number Portability)**

Gjatë vitit 2025 është finalizuar implementimi teknik i sistemit për bartshmërinë e numrave, ndërsa lansimi komercial pritet gjatë vitit 2026, në përputhje me afatet e përcaktuara nga autoriteti rregullator.

#### g. Perspektiva për të ardhmen

Gjatë vitit 2026, sipas planit të biznesit, të hyrat pritet të rriten rreth 10% — nga 67.8 milionë euro në 75 milionë euro.

Investimet e realizuara në modernizimin e rrjetit mobil, përfshirë implementimin e 5G dhe LTE 2100 MHz, kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve. Projekti i zgjerimit të rrjetit optik fiks pritet të fillojë të japë efekte nga fundi i vitit 2026 dhe fillimi i vitit 2027.

Kanali digjital 'Vala Jonë' ka shënuar rritje. Kontrata me partnerin kryesor të shitjes është rinovuar me kushte dukshëm më të favorshme — komisioni u ul nga 16% në 11%.

#### Telekomi synon:

- Rritjen e të hyrave me rreth 10% (drejt 75 milionë euro).
- Rritjen e mëtejshme të ARPU nëpërmjet pakove premium dhe shërbimeve konvergjente.
- Rritjen e bazës së konsumatorëve fiks përmes rrjetit optik të zgjeruar.
- Implementimin e VoLTE dhe lansimin komercial të Bartshmërisë së Numrave.
- Kontrollin e shpenzimeve, duke ruajtur investimet strategjike.

#### h. Rreziqet e të ardhmes së Korporatës

Menaxhimi i rrezikut është një nga faktorët e rëndësishëm për të siguruar performancë pozitive dhe zhvillim të qëndrueshëm të Telekomit të Kosovës, duke mbrojtur interesat e aksionarit, punonjësve, konsumatorëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Gjatë vitit 2026, rreziqet kryesore me të cilat përballet Kompania klasifikohen si më poshtë:

- Ligji i Prokurimit Publik, procedurat e prokurimit mund të shkaktojnë vonesa në furnizim dhe të kufizojnë fleksibilitetin në përzgjedhjen e teknologjive më të avancuara.
- Kompania përballet me konteste të ndryshme, përfshirë:
  - o paditë e punëtorëve (rrezik më i lartë, ndikim financiar i menaxhueshëm)
  - o rastet me vlerë të lartë financiare dhe me rrezik më të ulët për humbje
- Portabiliteti i numrave, implementimi në vitin 2026 mund të ndikojë në strukturën e tregut.
- Konkurrenca ilegale në shërbimet IPTV/OTT dhe ofertat alternative ndikojnë negativisht në të hyrat dhe pjesën e tregut.
- Vjetërsia e infrastrukturës në rrjetin fiks dhe sistemin energjetik kërkojnë investime të vazhdueshme.
- Dëmtimet në infrastrukturë, punimet nga operatorë të jashtëm ekonomikë në rrjetin optik.
- Moshë e avancuar e stafit dhe mungesa e kuadrove të reja teknike.

## i. Kalendar i financiar

---

Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin  
2025 nga Auditorët e Jashtëm duhet të  
prezantohet deri më datë:

**30.06. 2026**

---

Figurat e pasqyruara në këtë raport për vitin  
2025 paraqesin rezultatet preliminare të  
paaudituar.

---

Bazuar në kalendarin e pasqyruar më lart, raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Pasqyrat Financiare të Audituar pritet të publikohen deri më **30.06 2026**. Telekom i Kosovës është në proces të auditimit të Pasqyrave Financiare nga ana e Auditorëve të jashtëm – Nexia Kosova LLC për periudhën Janar-Dhjetor 2025, dhe pritet që brenda afatit ligjor të finalizohen Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit.

## VII. Shtojca

### a. Raportimet sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike

- i. Pasqyra e strukturës organizative
- ii. Përmbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruara ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP

i. Pasqyrat e strukturës organizative

Pasqyrat e strukturës organizative, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë vitit përkatës  
Struktura organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A




Figura 1 Struktura e re organizative

PAQYRA E NDRYSHIMEVE: Janar - Dhjetor 2025

Gjatë vitit 2023 ka filluar implementimi i procesit të ristrukturimit, përkatësisht kalimi nga struktura e vjetër organizative në strukturën e re organizative në të gjitha njësitë. Ky implementim ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025 dhe është përmbyllur në fund të këtij viti.

Gjatë periudhës raportuese të vitit 2025 janë shpallur gjithsej 122 konkurse të brendshme.

ii. Përmbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë korporatën

Deri më 31 dhjetor 2025, Kompania ka pasur gjithsej 979 lëndë aktive gjyqësore, të strukturuar si më poshtë:

Kategoria e Lëndës	Nr. i Lëndëve	% e Totalit
Konteste të punës (aktive)	735	75.1%
Konteste civile të ndryshme	106	10.8%
Lëndë ku TK është paditës	138	14.1%
<b>TOTALI AKTIV</b>	<b>979</b>	<b>100%</b>

Tabela 10. Procedurat gjyqësore

Kontestet e punës përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve (75.1%), duke reflektuar kompleksitetin e menaxhimit të burimeve njerëzore në një organizatë të këtij dimensionit. Pjesa tjetër përfshin konteste civile dhe raste ku kompania paraqitet në cilësinë e paditësit.